



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01 Nr. 18 /25
Me 30.09.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 12 pika 12.2 alinea d dhe nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, LMFPP Nr. 03/L-048, sipas Ligji Nr. 08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025 dhe nenit 44.1 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Transfer nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale

Neni 1

Aprovohet kërkesa Kryetarit të Komunës për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale komunale në shumën prej 10,481.45€.

Neni 2

Nga nën-programi Bujqësia (47014), fondi (21), kodi funksional (0421), nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere (20), shuma prej 8,000.00€ të transferohet:

Nga nën-programi Bujqësia (47014), fondi (10), kodi funksional (0421), nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere (20), shuma prej 2,481.45€ të transferohet:

Neni 3

Në nën-programin Administrata (16314), fondi (21), kodi funksional (0133), në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime (13) - shuma prej 8,000.00€.

Në nën-programin Administrata (16314), fondi (10), kodi funksional (0133), në kategorinë shpenzime komunale (13) - shuma prej 2,481.45€.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit dhe për zbatimin e këtij vendimi autorizohet Zyra e Kryetarit përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa/ZKF.

Arsyetim: Spas njoftimit nga Thesari datë 27.08.2025: "Konform nenit 40 të LMFP-së dhe legjislacionit tjetër në fuqi, Thesari është i obliguar të ekzekutojë vendimet gjyqësore/përmbartimore të formës së prerë, për të gjitha organizatat Buxhetore (OB) të caktuara në vendim në cilësi të debitorit.

Thesari njofton se, lëndët sipas listës bashkëngjitur tashmë pas procedimit janë në proces të ekzekutimit (zbatimit), në përputhje me të dhënat në vendimin/urdrin e formës së prerë. Ju mund të propozoni ekzekutimin e vendimit/ve në fjalë në përputhje me shpenzimin e krijuar sipas kategorisë ekonomike, si dhe të na konfirmoni nëse OB juaj ka bërë pagesë apo jo të këtyre obligimeve eventualisht, që të shmanget pagesa e dyfishtë. Nëse si OB keni dëshmi se pagesa është kryer, njoftoni menjëherë me shkrim Thesarin në adresat kopje të këtij email zyrtar, si dhe Autoritetin Përmbartues për stopim të ekzekutimit. Sqarim: Propozimet për ekzekutim mund të bëhen nga të gjitha kategoritë ekonomike përjashtimisht nga pagat."

Konform këtij njoftimi ne si OB sipas linjave të dërguara nga Thesari në SIMFK për bartje të mjeteve nga periudha TM4 kemi bartur mjetët në muajin Gusht 2025. Me datë 29.08.2025 janë ekzekutuar mjete në shumën prej 156,616.45€ në këto kategori ekonomike: mallra dhe shërbime në shumën prej 58,193.17€, shpenzime komunale 9,452.32€, subvencione dhe transferime 66,981.95€ dhe në kategorin shpenzime kapitale 21,989.95€. Gjithashtu me datë 16.09.2025 kemi pranuar njoftimin tjetër me listen e bashkëngjitur për ekzekutim, ku ne si OB e kemi njoftuar Thesarin që nuk kemi bilanc të lirë të mjeteve, ku kemi propozuar ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore/Përmbartimore të bëhet nga kategoria Paga dhe Shtesa dhe me datë 17.09.2025 është ekzekutuar vetëm shuma prej 1,595.41€ nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale.

Transferi nga kategoria subvencione dhe transferime shuma prej 10,481.45€ shprehur në përqindje është 13.10% nga nën-programi 47014-Bujqësia totali i buxhetuar për këtë nën-program është në shumën prej 80,000.00€ nga fondi (10) shuma 72,000.00€ dhe fondi (21) shuma 8,000.00€.

Mjetet e kërkuara për transfer në nën-programin 16314-Administrata, kategoria mallra dhe shërbime në shumën prej 8,000.00€ dhe në kategorin shpenzime komunale në shumën prej 2,481.45€, ku mjetët i kemi dedikuar tek nën-programi i Administratës Komunale 16314-Administrata sepse sipas aktëve ligjore dhe nënligjore kemi të drejtë të i mbulojmë shpenzimet në sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë. Këto mjete dedikohen shpenzimeve operative të Institucionit për muajin Shtator dhe Tetor 2025 për shpenzimet e shërbimeve, furnizime, etj dhe shpenzimet e rrymës, në mënyrë që mos të mbesim me obligime të cilat mundë të shkojnë në përmbartim në mungesë të mjeteve operative.

Transferi mjetëve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferime mbetet në përgjegjësin e organizatës buxhetore Komuna e Mamushës për mbulesë buxhetore dhe realizim në kategoritë operative të transferuara.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës
2. MAPL
3. Departamenti i Buxhetit Komunal – MFPT
4. Arkiv

Kryesues i Kuvendit të Komunës

Nesirudin Morina

